L I G J
Nr.7882, datë 1.12.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7530, DATË 11.12.1991 "PËR ORGANIZIMIN E SHËRBIMIT INFORMATIV USHTARAK DHE TË SHËRBIMIT TË KUNDËRZBULIMIT NË ORGANET E RENDIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7530, datë 11.12.1991 "Për organizimin e Shërbimit Informativ Ushtarak dhe të Shërbimit të Kundërzbulimit në organet e Rendit Publik", në nenin 2, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Shërbimi Informativ Ushtarak, si organ i specializuar informativo-gjurmues, organizon veprimtarinë e tij në Ministrinë e Mbrojtjes, në ndërmarrjen ushtarake, në njësitë e repartet ushtarake, si dhe në qendrat informative. Drejtimet dhe objektivat kryesore të punës së Shërbimit Informativ Ushtarak miratohen nga Këshilli i Mbrojtjes".

Neni 2

Në nenin 5 hiqen fjalët në fund "si dhe veprave kriminale".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.977, datë 9.12.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha